



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN**

Nr. 1576, Prot.

Tiranë, më 19.3.2019

Lënda: Kërkesë për miratim projekt urdhri

**SH.T.Z. EDI RAMA
KRYEMINISTËR**

**ZNJ. VALI BIZHGA
DREJTOR I KABINETIT TË KRYEMINISTRIT**

**Z. ENGJËLL AGAÇI
SEKTETAR I PËRGJITHSHËM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Zoti Kryeministër,

Në funksion të realizimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 9.5.2018 ju informoj si me poshtë:

- 1. Për zbatimin e masës 64 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, në datë 13.09.2018 u miratua Urdhëri Nr 135/2018 i Kryeministrit. Ai vlerëson realizimin e Masës 64 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës e cila kërkon:**

“Rishikimin dhe orientimin e programeve/donatoreve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Vlerësimi i kryerjes së një studimi të thellë mbi numrin e nxënësve shqiptare në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen.

Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë me jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit në kuadrin e programeve studimore të donatoreve të ndryshëm për Shqipërinë”

Në zbatim të Urdhërit Nr 135/2018 i Kryeministrit janë realizuar takime të Grupit të Punës në datat: 19 dhjetor 2018, 09 janar dhe 13 shkurt 2019.



Grupi i Punës në mbledhjet e tij diskutoi çështje që kanë të bëjnë me qëllim e realizimit të Masës 64 të Planit të Veprimit për Strukturën Kombëtare për Diasporën. Ai vlerësoi:

- Miratimin me akt nënligjor te modelit të kontratës me kusht kthimin në atdhe, që do te lidhet ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe studentëve të cilët do te studiojnë jashtë Shqipërisë me bursat te cilat do të koordinohen nga shteti shqiptar.
- Nevojën e një regjistri shtetëror për studentet te cilët studiojnë me bursat te cilat i jep apo i akordohen shtetit shqiptar.
- Domosdoshmërinë e koordinimit nga ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për bursat e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në veçanti për arbëreshët (Kroaci, Itali, Ukrainë).
- Propozimin për ngritjen e një sektori të veçantë për bursat brenda dhe jashtë vendit ne Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Caktimin e një Koordinatori Shtetëror për Masën 64.

Në frymën e propozimeve të mësipërme të Grupit të Punës:

1. U miratua nga Kryeministri Urdhëri Nr.47, datë 18.02.2019 "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit"
2. Ministri i Shtetit për Diasporën, me shkresën nr. 1152 Prot.,datë 22.02.2019 i ka propozuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, krijimin e një sektori te posaçëm për bursat pranë këtij institucioni.

Koordinatori Shtetëror do ndjekë ecurinë e zbatimit të Masës 64, të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.259, date 9.5.2018. Ai do te raportoje me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet Komitetit Shtetëror të Diasporës.

Në këto kushte, ishte vlerësim i përbashkët i Grupit të Punës të krijuar me Urdhrin Nr.135/2018 të Kryeministrit për zbatimin e Masës 64 fakti qe ky grup e ka realizuar qëllimin e tij dhe duhet konsideruar shfuqizimi i tij.



2. Për zbatimin e Masës 51 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, në Datë 13.09.2018 u miratua Urdhëri Nr 138/2018 i Kryeministrit. Ai vlerëson realizimin e Masës 51 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës e cila kërkon:

"Organizimin e rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato le organizatave ndërkombëtare."

Në zbatim të Urdhrit Nr.136/2018 i Kryeministrit janë realizuar takime të Grupit të Punës në datat: 27 dhjetor 2018, 11 janar, 13 shkurt dhe 13 mars 2019.

Grupi i Punës në mbledhjet e tij diskutoi çështje që kane te bëjnë me qëllimin e realizimit të Masës 51 te Planit te Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

Ai vlerësoi:

- Caktimin e "koordinuesit te informacionit mbi diasporën, i cili përcaktohet nga institucionet përgjegjëse për kontentin në faqet përkatëse nëpërmjet bashkëpunimit me AKSHI-n, i cili bën edhe mirëmbajtjen e tyre. Ai do të veprojë së bashku me zëvendësministrin dhe dy ekspertëve sipas Urdhrit Nr.98/2018 te Kryeministrit "Për përcaktimin e Grupit te Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 .
- Përmbledhjen në çdo institucion të informacionit për interesat e komuniteteve shqiptare jashtë vendit dhe të Identifikohet në faqet e tyre zyrtare me kontentin "Diaspora".
- Propozimin për caktimin e një Koordinatori Shtetëror për zbatimin e masës 51.
- Standardizimin e informacioneve për diasporën dhe migracionin. Si për shembull një propozim ishte vlerësimi i një rubrike "Mjek për Shqipërinë", për lehtësi aplikimi i mjekëve jashtë vendit, e cila si fillim konsiston ne njësimin e diplomës, pajisja me licencën e mjekut dhe më pas Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do te krijojë një profil në faqen e saj duke plotësuar kërkesën dhe specialitetin, që realizohet në bashkëpunim me AKSHI-n .
- Rekomandimi i cili u mbështet nga përfaqësuesi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në hapjen e rubrikës së "Diasporës në faqet e ambasadave dhe konsullatave të Republikës së Shqipërisë.



Në frymën e propozimeve të mësipërme të Grupit të Punës:

1. U miratua Urdhrit Nr.45, Datë 12.02.2019 të Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për informimin Diasporës". Në funksion të Masës 51 koordinatori do të vlerësojë dhe koordinojë punën për informacionin që publikohet nga institucionet e administratës shtetërore për interesat e komunitetit shqiptar jashtë vendit.
2. Ne përputhje me Urdhrit Nr.136/2018, në faqet zyrtare të institucioneve filloi aplikimi i rubrikës dedikuar informacioneve që lidhen me Diasporën.

Koordinatori shtetëror do ndjeke ecurinë e zbatimit të Masës 51, të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.259, Datë 9.5.2018, Ai do të raportojë me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.

Në këto kushte, ishte vlerësim i përbashkët i Grupit të Punës të krijuar me Urdhërin Nr.136/2018 të Kryeministrit për zbatimin e Masës 51, se ai e ka realizuar qëllimin e tij dhe duhet konsideruar shfuqizimi i tij

3. Për zbatimin e Masës 2 dhe Masës 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, në datë 13,09.2018 u miratua Urdhëri Nr. 138/2018 i Kryeministrit. Ai vlerëson realizimin e Masës 2 dhe Masës 4 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës të cilat kërkojnë:

Masa 2 kërkon:

“Miratimin në Komitetin Shtetëror për Diasporën e programit të programit vjetor për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes të përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin”

Masës 45 kërkon:

“Koordinimin dhe organizimin e takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë” në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.”



Në zbatim të Urdhrit Nr. 138/2018 të Kryeministrit janë realizuar takime të Grupit të Punës në datat: 18 dhjetor 2018, 10 janar dhe 13 shkurt 2019.

Grupi i Punës në mbledhjet e tij diskutoi çështje që kanë të bëjnë me qëllimin e realizimit të Masës 2 dhe Masës 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

Ai vlerësoi:

- Parimin e "bashkimit" të aktiviteteve të zhvilluara nga institucione te ndryshme shtetërore jashtë vendit në të njëjtin shtet, sepse edhe nga pikëpamja e shpenzimeve është më i arsyeshëm.
- Fokusin për zhvillimin e aktiviteteve në vendet ku ka diasporë shqiptare me numër më të lartë si Italia, Greqia të cilat nga ana e kostove janë të përballueshme.
- Koordinimin ndërinstytucional për planifikimin vjetor se çfarë aktiviteteve jashtë vendit do të konsiderohen për interesat e diasporës shqiptare dhe çfarë mund te propozohen si shtesë ndaj atyre ekzistues.
- Propozimin për caktimin e një koordinatori shtetëror në nivel zëvendësministri
- Krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si një mekanizëm efektiv në funksion të aktiviteteve për interesat e diasporës.
- Përfshirja në një sistem të "Shkollës Verore" të fëmijëve të diasporës

Në frymën e propozimeve te mësipërme të Grupit të Punës:

1. U miratua Urdhri i Kryeministrit Nr.44, date 12.2.2019 "Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror Për Organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare", ku përcaktohet se Koordinatori Shtetëror, në zbatim të masave 2 dhe 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, koordinon e organizon aktivitete në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar.

2. Agjencia Kombëtare e Diasporës përmbledhi të gjitha aktivitetet në një program të përbashkët dhe ia ka paraqitur për mendim Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit duke realizuar së bashku me Koordinatorin Shtetëror të parin Program Vjetor i cili u publikua dhe u shpërnda gjatë punimeve të Samit te Dytë të Diasporës.



3. Ministria e Kulturës ka hapur thirrjen për projekte nga operatorë të pavarur, duke përcjellë në këtë mënyrë aktivitetet e tjera të parashikuara nga institucioni i tyre, të cilat do të bëhen pjesë e programit të aktiviteteve vjetore.

Koordinatori Shtetëror do të ndjekë ecurinë e zbatimit të Masës 2 dhe Masës 45, të Planit të Veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me Vendimin të Këshillit të Ministrave Nr.259, datë 9.5.2018. Ai do të raportojë me shkrim çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.

Në këto kushte, ishte vlerësim i përbashkët i Grupit të Punës të krijuar me Urdhrin Nr.135/2018 të Kryeministrit për zbatimin e Masës 2 dhe Masës 45 se ai e ka realizuar qëllimin e tij dhe duhet konsideruar shfuqizimi i tij.

Duke marrë në konsideratë argumentet e mësipërme ju propozoj për miratim projekt-Urdhrin "Për shfuqizimin e Urdhrin Nr. 135, Date 13.09.2018, Urdhrin Nr. 136, Date 13.09.2018 dhe Urdhrin Nr.138, Date 13.09.2018".

**PANDELI MAJKO
MINISTËR**